



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

PROJEKTI FITUES ME TITULL:

**“STUDIM DHE ANALIZË MBI KOHERENCËN DHE STANDARDET  
E PRITSHME TË SPECIALISTËVE GJUHËSORË  
NË FUSHËN E TURIZMIT NË KONTEKSTIN SHQIPTAR”**

FINANCUAR NGA UNIVERSITETI I TIRANËS  
NË KUADËR TË PROGRAMIT “UT-KËRKIM, EKSELENCË DHE INOVACION”  
2023



**Ekipi i projektit:**

Dr. Drita RIRA (drejtuese e projektit)

Prof. Dr. Esmeralda Kromidha

Prof. Dr. Saverina Pasho

Prof. Asoc. Dr. Ogerta Koruti

Prof. Asoc. Dr. Alnida Koroshi

Znj. Vasilika Mulla



## Shkollë verore: “Potenciali i Itinerareve kulturore të Këshillit të Evropës në Shqipëri: burime të territorit”

The poster is blue with white text and features logos of the University of Tirana and the Faculty of Education. It includes an illustration of a classical building and a person with a presentation board. The text provides details about the program, dates, location, and registration information.

**SHKOLLA VERORE**  
"POTENCIALI I ITINERAREVE  
KULTURORE TË KËSHILLIT TË EVROPËS  
NË SHQIPËRI: BURIME TË TERRITORIT"

Ky program i shkollës verore u drejtohet studentëve që kanë dëshirë të punojnë në fushën e komunikimit dhe promovimit të trashëgimisë kulturore, në fushën e turizmit dhe studimit të burimeve turistike, në fushën e sipërmarrjes turistike apo të hartimit të projekteve kulturore dhe turistike.

Shkolla verore do të drejtohet nga ekspertë të Këshillit të Evropës për itineraret kulturore si edhe nga pedagogë të Universitetit të Tiranës.

**DATE 5-9.06.2023**  
**Salla "Evropa"**

Regjistrohuni duke skanuar QR Code

Organizimi i Shkollës Verore të Turizmit dhe Kulturës "Potenciali i Itinerareve kulturore të Këshillit të Evropës në Shqipëri: burime të territorit" u zhvillua në datat 5-9 qershor 2023.

Ky program i shkollës verore iu drejtua studentëve që aspirojnë të punojnë në fushën e komunikimit dhe promovimit të trashëgimisë kulturore, në fushën e turizmit dhe studimit të burimeve turistike, në fushën e sipërmarrjes turistike apo të hartimit të projekteve kulturore dhe turistike.

Shkolla verore u drejtua nga ekspertë të Këshillit të Evropës për itineraret kulturore si edhe nga pedagogë të Universitetit të Tiranës. Në këtë shkollë verore, që kishte si publik studentë të UT-së dhe jo vetëm, aktivitetet e organizuara ishin të karakterit mësimor-kërkimor me fokus itineraret kulturore dhe potencialet e tyre në Shqipëri.



Në ceremoninë e hapjes, më 5 qershor 2023, në ambientet e Sallës Evropë të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, përshëndetën me fjalën e tyre Dekania e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Prof. Dr. Esmeralda Kromidha, zv. Dekania, Dr. Drita Rira, njëherazi Koordinatore e kësaj shkolle verore dhe drejtuese e projektit, Prof. As. Dr Romeo Hanxhari dhe Prof. Dr. Sokol Axhemi nga Departamenti i Gjeografisë në FHF si edhe Z. Jean Luc Puyau, Atashe Gjuhësor pranë Ambasadës së Francës në Shqipëri.





Leksionet e mbajtura nga Prof. Pierre Frustier, ekspert i Këshillit të Evropës për Itineraret kulturore dhe Zj. Eléna Dubinina, Përgjegjëse e projekteve evropiane për Rrugën Via Francigena, u ndalën tek paraqitja dhe rëndësia e programit të Itinerareve Kulturore të Këshillit të Evropës, kriteret dhe objektivat e tij, duke parashtruar mundësitë potenciale për përfshirjen e trashëgimisë materiale dhe jomateriale në Itineraret ekzistuese të KiE-së edhe si një model zhvillimi ekonomik dhe kulturor.






Leksionet e mbajtura nga Prof. Pierre Frustier, ekspert i Këshillit të Evropës për Itineraret kulturore, Dr. Drita Rira, pedagoge në Departamentin e Gjuhës Frënge-FGJH, Prof. Asoc. Dr. Romeo Hanxhari dhe Prof. Dr. Sokol Axhemi nga Departamenti i Gjeografisë në FHF trajtuan tematika që lidhen me:

- Komunikimin turistik dhe veçoritë e tij në kontekstin e promovimit të territorit të Shqipërisë, duke zgjuar diskutime në lidhje me rolin dhe rëndësinë e të gjithë aktorëve të përfshirë në sektorin e turizmit për një komunikim sa më të suksesshëm të produktit turistik.
- Itineraret kulturore në Shqipëri: prezantimin e interesit, potencialet që paraqesin këto itinerare (për trashëgiminë, ekonominë): Atrium, Enea, Vreshtat, Ulliri, Trashëgimia Hebreje, Rruga Egnatia.





Leksionet vijuan me trajtesa nga Prof. Pierre Frustier, ekspert i Këshillit të Evropës për Itineraret kulturore, Z. Arnen SULA -Themelues Tek bunkeri, Zj. Rezarta BARE - Këshilltare për turizmin dhe zhvillimin e qendrueshëm rural (GIZ Shqipëri), Prof. Dr. Sokol Axhemi dhe Prof.As. Dr Romeo Hanxhari nga Departamenti i Gjeografisë në FHF të cilët u ndalën tek prezantimi i shembujve dhe modeleve që lidhen me aktivitete ekonomike dhe kulturore në territorin e Shqipërisë.





Gjatë shkollës verore u trajtuan gjithashtu tematika që lidhen me: rigjallërimin e trashëgimisë rurale; rehabilitime të bunkerëve në vende kulturore; valorizimin e kujtesës për burgun e Spaçit dhe u dhanë shembuj të turizmit me biçikletë në Shqipëri: slow tourism si një faktor zhvillimi ekonomik për kontekstin rural.

Atelieja përmbyllëse u përqëndrua tek puna kërkimore që zhvilluan studentët pjesëmarrës në këtë shkollë verore, nën drejtimin e Prof. Pierre Frustier, ekspert i Këshillit të Evropës për Itineraret kulturore. Rezultatet e kërkimit të tyre lidhen ngushtësisht me nevoja të zhvillimit të potencialeve të itinerareve kulturore të Këshillit të Evropës në Shqipëri.

Në fund të shkollës verore, në ambientet e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, studentëve iu shpërndanë Certifikatat e pjesëmarrjes.





Publikime mbi çdo ditë të këtij aktiviteti janë pasqyruar në web zyrtar dhe rrjetet sociale të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.





DITA 1 – link:

<https://www.facebook.com/FAKULTETIiGJUHEVEEteHUAJaiUT/posts/pfbid02pAE33KwfpHAVDwsp2qf8UfCcWSxh2WRN7LoWCwpNTQnogfFm4DDdxUXS1SjT2U7MI>

DITA 2 – link:

<https://www.facebook.com/FAKULTETIiGJUHEVEEteHUAJaiUT/posts/pfbid031pnJ5ctPDwVMDCeHk5uh8UBXsuzQvS4VYpMRSBvUGez3Tuq4oU97KekAEcNrAAUBI>

DITA 3 – link:

<https://www.facebook.com/FAKULTETIiGJUHEVEEteHUAJaiUT/posts/pfbid02TT2KaBcYgRPMegtF15e5N2LnEiDddG4JmN68tcaR1XQADr5gsDy1gmpSDXFsz6otl>

DITA 4 – link:

<https://www.facebook.com/FAKULTETIiGJUHEVEEteHUAJaiUT/posts/pfbid02tAWpqAdCckQJwtaPAocoYJTF5FwwDxWcfDUrufbDgk2FyqwJXiUfgL8GjuZj6fhXI>